

Akt Themelimi  
i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “SBR”

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregtare” dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqërite Tregtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 30/05/2022 une ortaku i vetem :

**1. Besart MEMETAJ i pajisur me ID Nr I70416108Q**

vendosa te krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “SBR” me akt themelimi si vijon:

**Neni 1**

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur “SBR”. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues .

**Neni 2**

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë “SBR” do te jetë: Himare, Rruga Potam, Ndertesa Nr 8, Hyrja Nr. 1
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:  
**sbr.himare@gmail.com**

Shoqëria mund te ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , te krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 3**

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve të ndryshme, hotelerisë, restoranteve, aktivitet turistik, transportues, menaxhimit, konsulencës dhe studimeve të të gjitha llojeve. Kryerja e investimeve në të gjitha fushat dhe kryesisht në atë të hotelerisë. Investimi i kapitalit dhe i mjeteve të tjera financiare për blerje pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme dhe në vazhdimësi të aktiviteteve të saj, shitja e tyre, blerja, marrja hua për të arritur qëllimet e Shoqërisë.

**Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë


Kohëzgjatja e shoqërisë do te jetë me nje afat 20 (njetzet ) vjecar . Ajo mund shpërbehet në cdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private “SBR” do të jetë 100 (njqind ) Lek dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues **Besart MEMETAJ** : Zotërues i një kuote te vetme që përbën 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.



**Neni 6**

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori z. **Besart MEMETAJ**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .

Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme .

**Neni 7**

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiarë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

**Neni 8**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

**Neni 9**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

**Neni 10**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

**Neni 11**

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “SBR”.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortaku i vetem “SBR”

**Besart MEMETAJ**

